



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 1891

Prishtinë, Dt. 15/06/2026

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Matematikë / Master në Shkencë Kompjuterike
Projektpropozimi	Detektimi i paragjykimeve dhe stereotipeve gjinore në raportimin e mediave për dhunën ndaj grave në Kosovë përmes Përpunimit të Gjuhës Natyrore (NLP)
Kandidati	B.Sc. Trime Ismajli
Mentori	Prof. Assoc. Dr. Eliot Bytyçi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 08.09.2025 Vendimi nr.: 2940
Vlerësimi i dorëshkrimit	
Hyrje Punimi i diplomës master me titull “Detektimi i paragjykimeve dhe stereotipeve gjinore në raportimin e mediave për dhunën ndaj grave në Kosovë përmes Përpunimit të Gjuhës Natyrore (NLP)” trajton një temë aktuale dhe të rëndësishme, e cila ndërlidh metodat bashkëkohore të përpunimit të gjuhës natyrore me analizën e diskursit mediatik në një fushë me ndjeshmëri të lartë shoqërore. Qëllimi kryesor i punimit është të analizojë mënyrën se si mediat online në Kosovë raportojnë për dhunën ndaj grave dhe të vlerësojnë mundësinë e identifikimit të paragjykimeve dhe stereotipeve gjinore përmes teknikave të NLP-së. Për këtë qëllim, kandidatja ka ndërtuar një korpus original me artikuj në gjuhën shqipe, të mbledhur nga portale mediatike në Kosovë, dhe ka aplikuar metoda të ndryshme kompjuterike, duke përfshirë modelimin e temave dhe klasifikimin automatik të tekstit.	
Kriteret e vlerësimit Vlerësimi i dorëshkrimit është bërë duke marrë parasysh rëndësinë e temës, strukturën e punimit, cilësinë e rishikimit të literaturës, përshtatshmërinë e metodologjisë, ndërtimin dhe përpunimin e dataset-it, përdorimin e modeleve NLP, analizën e rezultateve, interpretimin kritik të gjetjeve dhe cilësinë e përgjithshme të prezantimit akademik.	
Përmbajtja e detajuar Në kapitullin e parë, kandidatja paraqet hyrjen e studimit, kontekstin e problemit, rëndësinë e temës,	

objektivat dhe pyetjet kërkimore. Tema lidhet qartë me raportimin mediatik për dhunën ndaj grave dhe mundësinë e përdorimit të NLP-së për analizë sistematike të teksteve në gjuhën shqipe.

Kapitulli i dytë përmban rishikimin e literaturës mbi dhunën ndaj grave, raportimin mediatik, paragjykimet gjinore dhe përdorimin e metodave NLP në analizën e tekstit.

Kapitulli i tretë paraqet modelet e përdorura në punim, përfshirë LDA, BERTopic dhe mDeBERTa-v3 për klasifikim zero-shot dhe rafinim.

Kapitulli i katërt shpjegon metodologjinë, duke përfshirë përzgjedhjen e burimeve mediatike, ndërtimin dhe pastrimin e dataset-it, etiketimin manual dhe konfigurimin eksperimental të modeleve.

Kapitulli i pestë paraqet rezultatet e analizës eksploruese, modelimit të temave dhe klasifikimit të paragjyqimeve gjinore. Rezultatet janë të prezantuara me tabela dhe figura të mjaftueshme, ndërsa interpretimi është përgjithësisht i kujdesshëm.

Kapitulli i gjashtë përmbledh gjetjet kryesore, kufizimet dhe rekomandimet për hulumtime të ardhshme. Përfundimet janë të lidhura me objektivat e punimit.

Përmbledhje e të gjeturave

Punimi ka temë të rëndësishme, strukturë të rregullt dhe qasje metodologjike të përshtatshme për nivelin master. Kandidatja ka realizuar një punë të konsiderueshme në mbledhjen, pastrimin dhe etiketimin e të dhënave, si dhe në aplikimin e disa metodave të NLP-së për analizën e artikujve mediatikë në gjuhën shqipe.

Rezultatet tregojnë se modelimi i temave me LDA dhe BERTopic është i dobishëm për analizë eksploruese të strukturës tematike të korpusit, por nuk përputhet plotësisht me kategoritë manuale të dhunës. Po ashtu, qasja zero-shot ka performancë të kufizuar, ndërsa rafinimi i modelit në të dhëna shqipe sjell përmirësim relativ, edhe pse rezultatet mbeten modeste për shkak të pabarazisë së theksuar të klasave dhe natyrës subjektive të detyrës.

Kandidates i janë dërguar komentet nga anëtarët e e komisionit dhe do t'i përfshijë ato në versionin final.


Konkludim

Në përgjithësi, punimi i diplomës master i përmbush kërkesat themelore akademike dhe metodologjike për këtë nivel studimi. Tema është relevante, metodologjia është e arsyetuar, rezultatet janë të paraqitura në mënyrë të qartë dhe kandidatja ka demonstruar aftësi për të ndërtuar dataset, për të aplikuar modele të përpunimit të gjuhës natyrore dhe për të interpretuar rezultatet në raport me pyetjet kërkimore.

Komisioni rekomandon **pranimin** e punimit dhe lejimin e procedimit për mbrojtje publike, pas realizimit të disa korrigjimeve të vogla, të cilat kandidatja duhet t'i adresojë në versionin përfundimtar të punimit.

Prishtinë, 15/06/2026

Komisioni:

1. 
/ Prof. Asst. Dr. Korab Rrmoku – kryetar/
2. 
/ Prof. Assoc. Dr. Eliot Bytyçi – anëtar/
3. 
/ Prof. Asst. Dr. Artan Berisha – anëtar/